



[www.lezha.gov.al](http://www.lezha.gov.al)

# bashkia ime

Botim i Bashkisë Lezhë, Nr. 5, nëntor 2017



## 28 nëntori, Festa e Pavarësisë në Lezhë



Lezha në Kutina, fq 8





Prioritetet ReLOaD për Lezhën, fq 5



Arti lezhjan "shkrin" kufinjte, fq 8



Hartë arkeologjike e Lezhës, fq 14



## Redaksia

Drejtoria e Integrimit në BE dhe Programeve të Zhvillimit

Lajmet: Altin Mema, Rrok Lelçaj, Gjergj Figuri

Fotot: Olsi Tetaj

Redaktorë: Hekuran Koka, Xhulia Lekaj

Design: Hekuran Koka, Evaristo Coli

www.lezha.gov.al, pzhvillimi@lezha.gov.al



Rreth 29 kilometra vijë bregdetare, male, lumi e laguna, histori, arkeologji dhe një trashëgimi e pasur kulturore... Lezha mund t'i ofrojë të gjitha në një paketë të plotë turistike.

Ndërthurja e turizmit bregdetar me atë historik dhe natyror dhe kulinaria e pasur e bëjnë Lezhën një destinacion për turizëm gjithëvjetor.

I ndodhur në kryqëzim të rrugëve tregtare, historike e kulturore, pjesë e rëndësishme e kujtesës historike kombëtare, Lezha ka krijuar një përvojë të konsoliduar në fushën e turizmit. Vetëm 53 km larg kryeqytetit, qyteti i Lezhës ofron vlera të mëdha turistike, me objekte historike muzeale, arkeologjike si dhe objekte kulti si Kisha e themeluar nga Shën Françesku i Asizit ndërtuar në vitin 1240.

Kështjella e Lezhës konsiderohet më e madhja në Shqipërinë Qendrore si dhe simbol i arkitekturës ushtarake të vonë romake, bizantine e osmane. Ajo ndodhet mbi një kodër rreth 305 metra të lartë dhe rreth 80 metra prapa Kishës Françeskane.

Dhe nëse jeni të interesuar për turizmin historik, nuk mund të lini pa vizituar Memorialin e Skënderbeut, i ndërtuar mbi kishën e Shën Kollit, aty ku u varros Skënderbeu në 1468.

Kjo fotogaleri sjell Lezhën në të gjitha dimensionet e saj

## përmbajtja

Kryetari Frrokaj priti Zv.Kryeministren Mesi	4
Përcaktohen prioritetet ReLOaD për Lezhën	5
Ujë 24 orë me për 4 mijë banorë të fshatrave	6
Lezha në Kutina	8
Arti lezhjan "shkrin" kufinj të	8
Përballimi i shirave në Lezhë	9
Qendër komunitare për Romët	10
Dita ndërkombëtare e të drejtave të femijëve	11
Përkujtohet 73-vjetori i Çlirimit të Lezhës	12
Përkujtohet në Lezhë 28-Nëntori	13
HARTË ARKEOLOGJIKE E QARKUT LEZHË	14
"Biblioteka Lëvizëse", përvojë mbarëkombëtare	16
Takohemi për një libër	17
Përgatitjet e shkollave për stinën e dimrit	18
E-Albania në shërbim të plotë ndaj qytetarit	19
Nëntori sportiv në Lezhë	20

# Kreu i Bashkisë Lezhë z. Fran Frrokaj priti në një takim pune Zv.Kryeministren znj. Senida Mesi

Kryetari i Bashkisë Lezhë, Z.Fran Frrokaj, zhvilloi një takim pune me Zv.Kryeministren e Shqipërisë, Znj.Senida Mesi, e cila në fokus kishte verifikimin nga afër të punës me dokumentet elektronike, ku Bashkia Lezhë është ndër të parat që e ka finalizuar me sukses këtë proces. Në takimin e zhvilluar u diskutuan një sërë problematikash për të cilat kreu i bashkisë Frrokaj kërkoi ndërhyrjen e Qeverisë. Ai i bëri me dije Znj.Mesi, se një sërë projektsh janë dërguar për financim ndërsa kërkoi mbështetjen e saj në mënyrë të veçantë për rrugën e Torovicës dhe kopshtin e fëmijëve në qendër të qytetit, financim i cili është nisur nga Ministria e Arsimit dhe lënë përgjysmë. Kryebashkiaku e njohu Znj.Mesi edhe me disa shqetësime të tjera të cilat kanë penguar bashkinë në realizimin e investimeve. Frrokaj bëri me dije se borxhi i trashëguar prej 5.6 miliardë lekë ka vështirësuar punën e institucionit që drejton, sit-



uatë e cila ka ndikuar edhe në vonesën e likujdimit të pagave të administratës. Ndërkohë, deri tani bashkia ka likujduar rreth 2.6 miliardë lekë borxhe, fakt i cili është përshendetur nga Znj.Mesi e cila premtoi një qasje tjetër ndaj investimeve në këtë njësi vendore. Duke folur për shërbimet, Frrokaj i propozoi Zv.Kryeministres ndërtimin e një godine multifunktionale në periferi të qytetit me standarde bashkëkohore ku të gjithë qytetarët të marrin dokumentet e nevojshme në një vend, gjë për të cilën Znj.Mesi premtoi angazhimin e saj. Znj.Mesi foli edhe për taksat, ku kërkoi që të mblidhen pa asnjë përjashtim dhe se qytetarët duhet t'i paguajnë detyrimet në faturën e ujit të pijshëm. Kryebashkiaku Frrokaj i kujtoi Znj. Mesi se në shumë zona të Lezhës banorët jetojnë në kushte të vështira ekonomike, gjë e cila sjell jo pak probleme sociale e duke ndikuar njëkohësisht edhe në grumbullimin e këtyre taksave.



# Përcaktohen prioritetet ReLOaD për Lezhën

Në kuadër të programit ReLoad, të martën, datë 21 nëntor 2017, u zhvillua në Lezhë takimi i parë prezantues me anëtarët e shoqërisë civile. Ky takim shërbeu për të përcaktuar bashkërisht prioritetet e thirrjes së parë për projekt propozime, thirrje e parashikuar të hapet në muajt në vijim. Gjatë bashkëbisedimit me mbi 30 pjesëmarrësit u ra dakort që të punohet në tre drejtime, si dhe u përcaktuan përfaqësuesit e shoqërisë civile të cilët do të bëjnë pjesë në grupin vlerësues të projekteve. Prioritetet që u vendosën sëbashku janë:

1. Përfshirja sociale e grupeve në nevojë me në fokus gratë, fëmijët, moshën e tretë si dhe familjet me probleme sociale;
2. Promovimi i trashëgimise kulturore dhe turizmit me fokus tek të rinjtë, grupet e marginalizuara, aktivitetet e ndryshme sportive, etj;
3. Projekte për mjedis të qëndrueshëm.

Të tre prioritetet do të kenë vlerësimin më të lartë nëse krahas temës kryesore do të mbajnë parasysh ndihmën ndaj grupeve në nevojë, të rinjve dhe grupeve në nevojë. Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri (UNDP- PNUD), në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore (ReLOaD) financuar nga Bashkimi European ka përzgjedhur 12 bashki në Shqipëri, të cilat janë pjesë e skemës së grantit të Projektit me një vlerë prej rreth 100.000 euro për secilën bashki për një periudhë rreth 30 mujore. Kjo skemë granti do të shërbejë direkt për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile, të cilat do të ofrojnë shërbime në përputhje me prioritetet e bashkisë përkatëse. Granti do të menaxhohet në

bashkëpunim ndërmjet bashkisë së përzgjedhur dhe zyrës së UNDP në Tiranë. Grupi i vlerësimit të projekteve do të përbëhet nga 2 përfaqësues të bashkisë, 2 përfaqësues të programit ReLOaD, si dhe nga përfaqësuesi i shoqërisë civile i zgjedhur nga OSHC në takimin e djeshëm, Zj. Madalena Gega (e zëvendësuar nga Zj. Besmira Lekaj në rast konflikt interesi).

## ReLoad merr jetë

Me datë 1 Nëntor 2017, u organizua në Tiranë/ Qendra e Informimit të BE, ceremonia e firmosjes së Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet kryetarëve të 12 bashkive dhe Drejtoreshës së PNUD për Shqipërinë. Bashkia e Shkodrës, Lezhës, Elbasanit, Librazhdit, Dibrës, Përrenjasit, Korçës, Tiranës, Përmetit, Tropojës, Durrësit dhe Roskovecit, janë 12 bashkitë e përzgjedhura për të përfituar nga skema e grantit të Programit ReLOaD – një iniciativë rajonale e financuar nga BE, European Union in Albania dhe zbatuar nga UNDP. Pjesë e këtij takimi ishin edhe Romana Vlahutin - Kreu i delegacionit të Bashkimit European në Shqipëri; Brian J.Çilliams - Kordinator Rezident i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, si dhe Përfaqësuesi Rezident i UNDP-së në Shqipëri; Romina Kuko - Zv Ministre, Ministria e Brendshme; Andi Kananaj - drejtori ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile; Samir Omerefendic - regional Programme Manager / ReLoaD

# Në 2018, furnizim 24 orë me ujë për 4 mijë banorë të fshatrave

Nga Maela Marini/ATSH

Konsumatorët familjarë në Lezhë, regjistrojnë një borxh prej 264, 9 milionë lekësh në sektorin e ujit, duke qenë kështu debitorët kryesorë në raport me institucionet dhe bizneset. Ndërsa çmimi i ujit në Lezhë është 58 lekë/m<sup>3</sup>, borxhi i konsumatorëve familjarë arrin në 264,993,019.60 lekë. Reforma e ndërmarrë së fundi nga qeveria synon reduktimin e nivelit të borxheve si dhe uljen e humbjeve në rrjet, të cilat në Lezhë rezultojnë në një nivel prej 44.04 për qind. Në kuadër të reformës rrënjësore në sektorin e ujit të pijshëm, Kryetari i Bashkisë së Lezhës, Fran Frrokaj sqaron në një intervistë për ATSH-në disa nga problematikat në qarkun e Lezhës dhe hapat që po ndërmerr qeverisja vendore për mbështetjen e këtij aksioni.



## Sfidë, reduktimi i nivelit të borxheve

Bashkia e Lezhës po i përgjigjet aksionit të reformës në sektorin e ujit, duke pasur si synim kryesor furnizimin me ujë të pijshëm të qytetarëve dhe pagesën e detyrimeve nga ana e tyre.

Nisur nga kjo situatë, Bashkia e Lezhës po punon me institucionet përkatëse për pagesën e ujit, uljen e humbjeve dhe realizimin e treguesve, ndërsa po merren të gjitha masat për sensibilizimin e qytetarëve dhe reduktimin e nivelit të borxheve gjatë kësaj periudhe tranzitore, deri në vendosjen e penaltiteteve ndaj debitorëve.

Sa i takon debitorëve të tjerë, Frrokaj sqaron se për institucionet shtetërore niveli i borxhit arrin në 17,715,877.40 lekë; për bizneset 26,577,266.40 lekë dhe shitje me shumicë (komuna Kolsh) 5,059,261.00 lekë.

Aktualisht qyteti i Lezhës, Shëngjini dhe fshati Balldre furnizohen 24 orë me ujë të pijshëm, ndërsa njësitë administrative rreth 4 orë në ditë.



## Në 2018, furnizim 24 orë me ujë për 4 mijë banorë të fshatrave

Pas reformës territoriale, Frrokaj thekson se Bashkia e Lezhës ka riorganizuar sistemin e Ujësllës-Kanalizimeve, ndërmarrjen SH. A ujësllës kanalizimeve Lezhë, ku përfshihen ujësllësi qytet Lezhë- Shëngjin- Balldre, si edhe ujësllësat e fshatrave (ish komunat). Për periudhën janar-shtator 2017, niveli i humbjeve në rrjet është 44.04 për qind, thekson Frrokaj.

“Ujësllësi qytet është rikonstruktuar (Lezhë –Shëngjin- Balldre) në vitet 2015-2017 nga ana e Bankës Gjermane për zhvillim ( KfW ) projekt i cili mbulon 45000- 50000 banorë. Ky projekt ka mbuluar me matësa, familjarët dhe bizneset në çdo njësi. PAGESA E FATURAVE TË UJIT BËHET PRANË ZYRAVE PËRKATËSE SH.A Ujësllës Kanalizime, postës ose aplikacioneve të tjera pasi faturimi është i realizuar nëpërmjet programeve të ujësllësit”, shprehet Kryetari i Bashkisë. Gjatë vitit 2017, sipas tij, është riorganizuar ujësllësi fshat që përbëhet nga njësitë Kallmet, Blinisht, Dajç, Balldre dhe Zejmen, për të cilat faturimi dhe ndjekja bëhet nga operatorët e ujësllës-kanalizimeve dhe në arkat e ndërmarrjes.

Në kuadër të projekteve për vitin 2018, Frrokaj thekson se “bashkia Lezhë ka fituar projektin e ujësllësit të fshatit Kallmet me vlerë 1,401,000 Euro, që do financohet nga KfW si edhe 10 % bashkëfinancim nga Bashkia Lezhë”. Sipas këtij projekti synohet furnizimi me ujë të pijshëm 24 orë për rreth 4000 banorë të fshatrave Kallmet i Madh dhe Kallmet i Vogël.

Gjithashtu, kryetari i Bashkisë së Lezhës shprehet se “nëpërmjet ndërmarrjes SH.A do të punohet për mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues si edhe për aplikimin në projekte të reja”.



## Kreu i Bashkisë Lezhë, Fran Frrokaj, vizitë zyrtare në Kutina të Kroacisë

Kryetari i Bashkisë Lezhë, z.Fran Frrokaj, i shoqëruar nga Kryetari i Këshllit Bashkiak, z. Kristian Gjidoaj, si dhe pjestarë të stafit të tij, zhvilloi në Bashkinë Kutina në Kroaci një vizitë zyrtare me ftësë të këtyre të fundit. Qëllimi dypalësh ishte diskutimi i mundësive të shkëmbimit të eksperiencave të cilat ndikojnë në përmirësimin e disa standarteve jetësore të qytetarëve. Delegacioni nga Lezha u prit nga Kryetari i Bashkisë së Kutinjës z.Zlatko Babic dhe Prefekti i Rajonit të Sisak-Moslavina z.Ivo Zinic.

Në fjalimin e mbajtur, Frrokaj bëri një prezantim të resurseve dhe mundësive që ofron Lezha. Kryebashkiaku ftoi investitorët kroat që të jenë të pranishëm në Lezhë duke i garantuar se do të kenë mbështetjen e duhur nga ana e bashkisë dhe gatishmërinë për bashkëpunim. Miqtë kroat u ftuan nga z.Frrokaj që të marrin pjesë në përvjetorin e "Besëlidhjes së Lezhës", ku bashkia ka planifikuar një sërë aktivitete.



## Arti lezhjan "shkrin" kufinj të

Me ftësë të shqiptarëve të Tetovës në Maqedoni, shqiptarëve në Luginën e Preshevës dhe Bujanoc në Serbi si dhe në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë, një delegacion i Bashkisë Lezhë ndërmori një tur për të promovuar Lezhën në aspektin historik dhe krijimin e urave të promovimit të kulturës mes fëmijëve duke pasur parasysh vitin jubilar të Gjergj Kastriotit-Skenderbeu.

Në këtë mënyrë, Qendra Kulturore e Fëmijëve në bashkëpunim me shkollën "Lezha Academic Center" përcollën emocione dhe mesazhe të vëllazërisë, ndërsa u pritën nga qindra bashkëmoshatarë të tyre në territoret shqiptare që u lanë jashtë kufinjve padretësisht të Shqipërisë aktuale. Delegacioni i Bashkisë Lezhë u prit nga autoritetet shqiptare atje duke u vlerësuar edhe me titull "Mirënjohjeje", ndërsa një pritje të posacme kishte rezervuar deputeti Partisë Demokratike Shqiptare në Parlamentin e Serbisë z. Ragmi Mustafa.

Bashkia Lezhë i ftoi gjithë shqiptarët që me 2 Mars të marrin pjesë masivisht në festën që do të organizohet në Lezhë në nderë të Besëlidhjes së Lezhës apo dhe aktivitete të tjera të kësaj natyre



## Përballimi i shirave në Lezhë

Gjatë datës 30.11.2017 dhe deri në orën 10:00 të datës 01.12.2017 në të gjithë territorin e Bashkisë Lezhë kanë vazhduar reshjet e shiut. Intensiteti ka qenë 40 mm gjatë ditës dhe 35 mm gjatë natës. Situata në terren nuk ka qenë problematike lidhur me reshjet që kanë rënë, përjashtuar Njësinë Administrative Blinisht ku kemi rreth 20 ha tokë në zonën Baqel e Kodhel më pak uje mbi sipërfaqe, këto ujëra po evadohen në kanalet e dyta dhe të para. Kuotat e lumit Drin janë në kufinj normale, 0.9 m nga 2.2 m që është kuota maksimale. Kanalet e ujërave të larta dhe lumi Gjadër janë në kuota normale dhe pa problem për përmbytjen. Hidrovoret në Tale, Balldre, Ishull-Shëngjin dhe Gocaj kanë funksionuar normalisht dhe janë në kuota normale. Hidrovori i Grykë-Zezes ka pasur probleme me energjinë elektrike, por gjendja është normalizuar me ndërhyrjen e OSHE-së. Prurjet e përrrenjve kanë qenë normale. Rezervuarët e ujit janë në kuota mini-



male dhe aktualisht nuk paraqesin problem për përmbytjen. E rëndësishme është në të gjithë territorin nuk kemi rrezik për përmbytjen e banesave, megjithëse reshjet do vazhdojnë të bien. Furnizimi me energji elektrike në përgjithësi ka qenë i rregullt, përjashtuar disa prerje të herëpashershme në Njësitë Administrative Dajç (fshati Zojz dhe Gjadër), Balldre, fshati Torovicë dhe në Zejmen. Furnizimi me ujë të pijshëm nuk ka pasur problem. Problem mbetet situata e masiveve shkëmbore që janë në pozicione kritike dhe rrezikojnë shkëputjen në drejtim të qendrave të banuara në Torovicë dhe në Tresh. Në Njësinë Administrative Shënkoll, në Tale 2, z.Ndoc Dragusha ka paraqitur problemin e bllokimit të rrugës nga uji dhe kërkon mbështetje për mbushjen e saj. Në rast reshjesh të vazhdueshme, Drejtoria e Emergjencave Civile dhe e Menaxhimit të Krizave, Bashkia Lezhë, do i vijë në ndihmë familjeve të prekura nga fatkeqësitë natyrore.



## Qendër e re komunitare në Lezhë për komunitetin rom dhe egjiptian

Është peruruar në Lezhë Qendra e re Komunitare e cila do vihet në shërbim të komunitetit rom dhe egjiptian. Organizata Shqiptare e Urdhrit të Maltës, në kuadrin e zbatimit të programeve në mbështetje të njerëzve në nevojë, në partneritet me Bashkinë Lezhë dhe donatorët e saj ndërkombëtarë, ka mundësuar funksionimin e kësaj qendre për të cilën u investuan 100 mijë euro. Në këtë ceremoni morrte pjesë dhe nunti apostolik në vëndin tonë, mon sinjor Xhons Braun. Sipas investitorëve, ishte programuar që kjo qendër të ndërtohej në qytetin e Shkodrës, aty ku Malteser - Shqipëri ushtron aktivitetin kryesor prej 25 vitesh, por pas shumë orvatjesh dhe problemesh burokratike të pushtetit lokal, u vendos që qendra e re të transferohej në Bashkinë e Lezhës e cila e mirëpriti këtë nismë. Kreu i Bashkisë së Lezhës z.Fran Frrokaj, duke falenderuar investitorët, i ftoi ata për bashkëpunime të tjera në shërbim të njerëzve në nevojë, pasi institucioni që ai drejton do eliminojë çdo barrierë që pengon investimet për këto shtresa. Pranë godinës së re të Qendrës Komunitare, bekimi i së cilës u bë nga nunti apostolik monsinjor Xhons Braun, është ngritur dhe një fushë kalçetore futbollit, ku do luajnë fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, gjithashtu edhe një kënd lojrash. Kjo qendër ofron shërbime ditore për parashkollorët, për fëmijët që kanë nevojë për asistencë të diferencuar në mësimë e detyra si dhe konsulencë psikologjike dhe juridike për komunitetin. Ky investim do të shoqërohet dhe me një mbështetje tjetër financiare për shërbimet që do të ofrohen në këtë qendër për 10 vitet e ardhshme.



## Dita ndërkombëtare e të drejtave të fëmijëve

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, Bashkia Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Arsimit, shoqatën “World Vision” dhe Drejtorinë e Policisë, organizuan një takim sensibilizues për mbrojtjen e të drejtave themelore të fëmijëve me temë: “Buzëqeshim nëse jetojmë në një komunitet pa dhunë”. Përmes skeçeve improvizuese fëmijët sollën raste pozitive të respektimit të të drejtave të tyre, por dhe shembuj kur ato çënohen. E themeluar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1954, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, u tha në takim, synon të promovojë mirëqenien e fëmijëve kudo, të parandalojë çdo formë dhune apo abuzimi ndaj tyre, si dhe të inkurajojë mirëkuptimin. I pranishëm në këtë takim, kreu i Bashkisë së Lezhës zoti Fran Frrokaj theksoi se do të japë gjithë mbështetjen për parandalimin e dhunës tek fëmijët që ende e hasim si një fenomen që rrezikon zhvillimin, shëndetin, mirëqenien, të drejtat

themelore të fëmijëve, dinjitetin dhe të ardhmen e tyre.

Në këtë kuadër, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve pranë Bashkisë Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore, përfaqësues të shoqatave dhe shoqërisë civile, ka hartuar dhe po zbaton planin kombëtar të veprimit “Stop Dhunës në Shkollë”, me synimin për të parandaluar fenomenin e dhunës në të gjitha shkollat e rrethit.

Ndërkohë, drejtues të bashkisë, arsimit, policisë dhe World Vision, ftuan të gjithë nxënësit e pranishëm, mësuesit, prindërit dhe çdo qytetar të Lezhës që, të mos hezitojnë të denocojnë çdo akt dhune i cili çënon të drejtat themelore të fëmijëve tanë, gjithashtu, të bëhen pjesë e rëndësishme e përfshirjes së tyre në promovimin dhe zbatimin e këtij plan-veprimi, i cili tanimë u është shpërndarë të gjitha shkollave të Lezhës.



## Përkujtohet 73-vjetori i Çlirimit të Lezhës

Është përkujtuar 73 vjetori i Çlirimit të Lezhës. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm drejtues të pushtetit lokal, veteranë, pjestarë e të afërm të familjeve të të rënëve për liri dhe qytetarë të Lezhës, të cilët vendosën kurora me lule dhe bënë homazhe tek varrezat e dëshmorëve. Kreu i Komitetit të Veteranëve të Lezhës, Deli Bisha, duke evokuar heroizmin e të rënëve për liri, e ka vlerësuar Ditën e Çlirimit të Lezhës si një ngjarje me rëndësi historike. Zv.kryetari i Bashkisë z.Enver Hafizi tregoi rreth luftës së bërë 73 vite më parë për çlirimin e vendit, duke kujtuar dhe nderuar dëshmorët e Lezhës që dhanë jetën për liri. Në fjalën e tij përshëndetëse, Hafizi theksoi: “Ne këtë ditë të gjithë ne nderojmë heroizmin e atyre që rroken armët kundër okupatorit fashist për një shqipëri të lire dhe demokratike”. Antifashizmi shqiptar, u shpreh në fjalën e tij kryetari i veteranëve të qytetit Lezhë, Nikoll Gjoni, do të mbetet

një faqe e ndritur e historisë së popullit tonë dhe ne u jemi mirënjohës partizanëve për luftën e drejtë që bënë për çlirimin e Lezhës dhe gjithë vendit. Lufta e dytë botërore dhe ajo Nacional-Çlirimtare mbeten një vlerë historike dhe pasuri kombëtare. Përshëndetën në këtë ceremoni përkujtimore të përvjetorit të 73-të të çlirimit të Lezhës, veteranë të luftës, pjestarë e të afërm të familjeve të dëshmorëve. Më pas, gjithë të pranishmit, duke parakaluar para varrezave nderuan dëshmorët e Lezhës të cilët dhanë jetën për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Bashkia e Lezhës në nderim dhe përkujtim të kësaj Dite kishte organizuar dhe aktivitete të tjera, të cilat vijuan me hapjen e ekspozitës së pikturës “Arti Pamor Lezhjan 2017”. Në këtë ekspozitë merrnin pjesë 29 piktorë të afirmuar dhe të rinj që, me tematikën e lirë sollën 60 punime në gjinitë e peisazhit, portretit, natyrës së qetë, skulpturës dhe mozaikut.



## Përkujtohet në Lezhë 28-Nëntori, 105-vjetori i shpalljes së Pavarësisë Kombëtare

Në përkujtim të 28-Nëntorit, 105-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, Bashkia e Lezhës në nderim të kesaj Date me rëndësi historike organizoi disa veprimtari. Me këtë rast, fillimisht, pranë Flamurit Kombëtar, në sheshin para Obeliskut të Kuvendit të Lezhës, u mbledhën qytetarë,



autoritete të pushtetit lokal, autoritete të besimeve fetare, deputetë, intelektualë dhe nxënës shkollash të cilët vendosën tufa me lule. Ndërkohë kryetari i Bashkisë z.Fran Frrokaj nën tingujt e hymnit kombëtar të bandes frymore të fëmijëve, bëri ngritjen e Flamurit. Në fjalën e tij përshëndetëse, Frrokaj e ka vlerësuar 28-Nëntorin si një datë të rëndësishme historike, pikë kulmore kthese, për fatet e Kombit Shqiptar. Duke evidentuar kontributin e atdhetarëve patriotë, që e kryen me sukses misionin e tyre, ai dha mesazhin se kjo ditë e madhe duhet t'i bashkojë shqiptarët kudo që janë me një vullnet të ri për t'ju rikthyer shembujve shtetformues të Ismail Qemalit, Isa Boletinit, Luigj Gurakuqit e themeluesve të tjerë të shtetit shqiptar, figura të ndritura të kombit tonë, që meritojnë nderim të perjetshëm. Ndaj, përfundoi fjalën e tij Frrokaj, duke apeluar për respekt e mirënjohje të thellë për çdo shqiptar që ka kontribuar e kontribuon ndër vite për pavarësinë, lirinë e prosperitetin e shqipërisë tonë të dashur. Përshëndeti me këtë rast edhe prefekti i Lezhës, z.Gjergj Pren-di, i cili duke uruar për Festën e Flamurit e vlerësoi këtë datë historike si mjaft të rëndësishme për fatet e kombit shqiptar. Më pas në sallën e pallatit të kulturës u dha një koncert artistik me numra të zgjedhur kushtuar festës së Flamurit, 105-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, ku interpretuan aktorë, vallëtarë, këngëtarë, instrumentistë, nxënës shkollash dhe artistë e krijues të Lezhës.

# HARTË ARKEOLOGJIKE E QARKUT LEZHË

DED MARGJONI

Hapësira midis lumenjve Mat dhe Drin, në derdhjen perëndimore të tyre, është e pasur me monumente arkeologjike, nga të cilat ato ilire zënë një vend të rëndësishëm në historinë e kulturës së lashtë të popullit tonë. Duke sfiduar harresën që shkaktojnë mijëvjeçarët në këtë hapësirë, ende ruhen gjurmët e qytetërimit iliro-arbëror, për ti patur edhe sot si dëshmi të gjalla të një trashëgimie të largët që lidhet me rrënjët e popullit tonë, që nga epoka enolitike e deri më sot.

Disa nga këto monumente arkeologjike të paraqitura në këtë hartë skicë, kanë qene prej dekadash objekt i gërmimeve arkeologjike dhe i studimeve të imta shkencore, por disa të tjera që janë të paraqitura këtu, janë akoma të pa vëzhguara nga specialistët e fushës.


Për shkak të numrit të madh të tyrë, përveç kishave paleokristiane, në këtë hartë, nuk janë paraqitur kishat e dy fazave të fundit të Mesjetes, si dhe banesat popullore të shpallura monumente kulture. Më konvencionin "gjurmë arkeologjike", këmi paraqitur në skicë katër vende (Tresh e Kolsh, të Lezhës, Malbardhë të Kurbinut dhe Gziq të Mirditës), ku nëpërmjet fragmenteve të imta të qeramikës, ende ruhen gjurmë të një qytetrimi mjaft të hershëm, i cili mund ti përkasë epokës enolitike, ndoshta edhe të një popullsie parailire.

Tëk rubrika "vendbanime prehistorike", krahas arkitekturës e qeramikës së vënë re, duhet thënë se nuk këmi paraqitur vendet ku janë gjetur vegla prej guri kryesisht sopatat, pasi gjetjet janë të


shumta në numër e në gjeografi, gjë e cila do shkaktoje një rëndësi vizuale të hartës.

Tëk "depo e thesarë" duhet sqaruar se janë paraqitur vendet ku janë gjetur sopata bronz, konkretisht ato në afërsi të Torovicës (125 copë), në botimet shkencore shkruhen si "Thesari i Torovicës", dhe sopatat (7 copë) të gjetura në fshatin Spiten.

Ky punim vjen si rezultat i vëzhgimeve arkeologjike të kryer nga ana jonë që prej 17 vitesh në Qarkun e Lezhës, por edhe në disa rrethe kufitare me të, gjurmët arkeologjike të cilëve nuk i kemi pasqyruar, konkretisht ato të diktuar në rrethin e Pukës dhe atë të Shkodrës. Vëzhgimet tona kanë qenë të pa inkuadruara në ndonjë survey arkeologjik shkencor i cili ka një objektiv të caktuar, më një strategji të qartë dhe logjistikwn e duhur, kwsisoj është e pranueshme që ky punim s'mund të përjashtohet nga mundësia për të pasur ndonjë pasaktësi në aspektin datimor, por gjykojmw se mund të ketë vlera orientuese për arkeologwt si edhe studiuesit e tjerë të shkencave simotra, si dhe mund të ngjallë interes edhe tek lexuesi i thjeshtë.



## HARTË ARKEOLOGJIKE E LEZHËS, KURBINIT, MIRDITES.





# Bashkia Lezhë me projektin "Biblioteka Lëvizëse", përvojë efikase mbarëkombëtare

Lezha e traditës së spikatur historike e letrare i sjell Shqipërisë një "Besëlidhje" të re - të gjithë bashkë për ta dërguar librin në çdo cep të vendit! Në një takim kombëtar për leximin, me përfaqësues nga të gjitha bibliotekat e vendit, biblioteka "Gjergj Fishta", në të dytin vit të realizimit të shërbimit të librit në zonat periferike të Lezhës, me projektin " Biblioteka Lëvizëse", ka ndarë me simotrat e saj këtë përvojë. Suela Bala, drejtuese e bibliotekës dhe zbatuese e këtij projekti solli përvojën e fituar dhe argumentoi mënyrat se si ajo mund të bëhet pjesë e çdo biblioteke në shkallë vendi. Drejtues të bibliotekave të bashkive e vlerësuan këtë përvojë të Lezhës si mjaft efikase në dërgimin e librit pranë lexuesve deri në zonat më periferike të çdo njësie vendore. Një bashkëbisedim efektiv ky që synonte për të arritur të pamundurën, shpërndarjen e librit në çdo cep të Shqipërisë. Pas bisedave e diskutimeve takimi u mbyll me firmosjen e një rezolute të përbashkët për ta ngritur problemin e përhapjes së librit dhe nevojën e leximit të tij në një emergjencë kombëtare, që lidhet me edukimin e formimin kulturor të lexuesve në përgjithësi e sidomos të fëmijëve dhe të rinjve në veçanti.

## Një libër në çdo cep të vendit!

Privilegj dhe kënaqësi e veçantë të ndash me dashamirës të librit, historinë tonë të bukur të udhëtimit me libra tek fëmijët dhe të rinjtë në çdo shkollë të Lezhës. Biblioteka Lëvizëse përfundoi me sukses shpërndarjen e librave në disa fshatra të Lezhës. Saktësisht, gjate muajit nëntor 2017 u bene keto dergesa:

1. Nxënësit e dy shkollave në Blinisht, për këtë muaj u lexuan 36 libra nga të vegjëlit dhe 40 nga të rriturit.
2. Nxënësit e Spitenit lexuan 48 libra.
3. Nga 100 nxënës që mësojnë në shkollën e Pllanës, 33 prej tyre morën libra.
4. Nxënësit e shkollës në Ishull Lezhë morën 70 libra.
5. Nga nxënësit e Rraboshtes u lexuan 33 libra, në Kallmet u lexuan 24 libra.
6. Në kopshtet dhe shkollat fillore të Kallmetit, Fishtës, Krajan, Baqel, Kodhel e Dragushe u dërguan 70 libra.
7. Në Zejmen u dërguan 91 libra.



# Takohemi për një libër

Për lexuesit e vegjël të Lezhës, me datë 09.11.2017, ora 10.30, erdhi në Bibliotekën "Gjergj Fishta", shkrimtari për fëmijë Xhahid Bushati, autor i më shumë se 30 librave me vjersha, poema, përralla e tregime.

Pse shkruan për fëmijë? Kur je shkrimtar vetë, a lexon libra të tjerë? A ke patur frikë për ndonjë libër se në fëmijët nuk do ta pëlqejmë? Këto dhe shumë pyetje të tjera mori shkrimtari i Letërsisë për Fëmijë Xhahid Bushati, nga fëmijët e Lezhës, ndërsa ishte i ftuar në Bibliotekën "Gjergj Fishta", për të lexuar bashkë me ta, librat e tij. Ndërsa mësuan disa "sekrete" nga xhaxhi shkrimtari, fëmijët u njohën me disa nga mbi 30 librat e tij me vjersha, poema, tregime, përralla, të cilat i lexuan pa pritur dot rradhen. Nga klasat e treta, të katërta, të pesta dhe të gjashta, fëmijët mësuan se në shtëpinë e shkrimtarit të tyre ka më shumë se 10 mijë libra dhe një orar të përditshëm leximi, ndërsa shkruan për ta " me kujdesin e madh, që t'i gëzohen bukur moshës së tyre". Shkrimtari i ftuar, Xhahid Bushati, falënderoi fëmijët, mësuesit dhe prindërit për praninë e tyre në takim, gjithashtu, premtoi se do të përsëritet me daljen e librit të ri.



# Poetessa e vogël, Sibora Huda, vizitë në Bibliotekën "Gjergj Fishta"

Me datë 18.11.2017, ora 11.00, në ambjentet e Bibliotekës "Gjergj Fishta", lexuesit e vegjël të Lezhës patën mundësinë të bashkëbisedonin me poeteshën e vogël, autoren më të re në moshë, Sibora Huda. Sibora Huda nuk ka mbushur akoma 10 vjeç, por është autore e tre librave, ndërsa është vlerësuar me disa çmime kombëtare e ndërkombëtare për poezinë e saj. Në këtë takim morën pjesë nxënës të klasës së katërt të shkollës "Ali Demi" në Tiranë.

Sibora bëri miq të rinj në bibliotekë, ndërsa "ditarin" e saj me poezi e shfletuan bashkë ajo vetë dhe lexuesit e vegjël të Lezhës. 10 vjeçarja Sibora Huda ka botuar tre libra me poezi, por tregoi se i pëlqen shumë të luajë, të lexojë deri vonë dhe të mbajë ditarin e saj - ku ka vargje për emocionet dhe mendimet e çdo dite, teksa i gëzohet gjetheve, shiut, njerëzve dhe jetës. Ajo i këshilloi moshatarët e saj të mbajnë ditar, të shkruajnë atë që ndjejnë, se kështu pastrojnë zemrën dhe mendjen ... e të lexojnë shumë.



## Përgatitjet e shkollave për stinën e dimrit

Në kuadër të përgatitjeve për pritjen e stinës së dimrit, që në fillim të muajit Bashkia Lezhë ka marrë disa masa për të siguruar bazën materiale për furnizimin pa ndërprerje të shkollave me lëndë djegëse, për të garantuar mbarëvajtjen e procesit mësimor në të gjitha shkollat në territorin që ka në kompetencë.

Gjatë kësaj kohe janë inspektuar sistemet e ngrohjes në të gjitha shkollat dhe janë identifikuar të gjitha nevojat e shkollave për të garantuar kushte optimale për nxënësit dhe mesuesit. Prioritet për furnizimin me dru kanë patur çerdhet, kopshtet dhe fëmijët në klasat e arsimit fillor. Është kryer furnizimi me lëndë djegëse, duke furnizuar me naftë kaldajat dhe janë shpërndarë 93 m<sup>2</sup> dru zjarri në shkolla të ndryshme. Shpërndarja e druve do të vazhdojë edhe përgjatë muajit dhjetor. Në të gjitha shkollat janë vendosur xhamat e dëmtuar. Njëkohësisht ka vazhduar pa ndërprerje puna për përmirësimin e kushteve në objektet arsimore me qëllim përmirësimin e proçsit mësimor-edukativ.

Këtë muaj Bashkia Lezhë ka lidhur kontratën me firmën fituese të tenderit për rikonstruksionin e Shkollës së Mesme të Bashkuar Zejmen.



## Administrata e Bashkisë Lezhë dhe nxënësit e shkollave marrin pjesë në aksionin kombëtar për pastrimin e mjedisit

Administrata e Bashkisë Lezhë dhe ato të Njësive Administrative, bashkë me mesuesit dhe nxënësit e shkollave, kanë marrë pjesë në aksionin kombëtar të pastrimit të mjedisit. Sipas një plan-veprimi të hartuar nga Bashkia, është ndërhyrë në 30 zona që paraqesin më probleme për sa i takon pastrimit të territorit nga mbetjet. Nxënësit dhe punonjësit e administratës janë pajisur me thasë dhe doreza, të cilët kanë krehur jo vetëm rrugët dhe lagjet e qytetit, por edhe qendrat e njësive administrative dhe zonat e tjera periferike. Të gjitha mbetjet e grumbulluara janë zbratur në kontinerët e instaluar. Ndërkohë, nxënësit dhe administrata e Njësive Shëngjin, krahas mbledhjes së mbeturinave në qytet, kanë ndërhyrë dhe në vijën bregdetare të plazhit. Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe ajo e Turizmit i paraprinë këtij aksioni dhe në ditët në vijim kanë detajuar ndërhyrje të tjera për pastrimin e mjedisit dhe gjithë territorit të Bashkisë Lezhë. Sipas një plani strategjik të mirëstudiuar punohet me moton: "Për një Lezhë turistike sa më të pastër".



## E-Albania tashmë në shërbim të plotë ndaj qytetarit

Të gjithë qytetarët shqiptarë tashmë mund të shkarkojnë dokumente zyrtare online nga portali e-albania, të cilat të pajisura me vulën elektronike kanë të njëjtën vlerë ligjore si dokumentet fizike me vulë të njomë. Marrja e dokumentit elektronik kërkon identifikimin e kërkuarit përmes të dhënave të kartës së identitetit/pasaportës dhe kthimi i dokumentit me vulë vjen nëpërmjet integritetit të sistemeve përkatëse me një sërë teknologjish të reja që garantojnë transaksion të sigurt nga të dyja palët. Po kështu dokumenti elektronik i pajisur me vulë elektronike (dhe që mund të printohet nga vetë përdoruesi), mund të përdoret nga qytetarët në dosje aplikimi si dokument shoqëruar, si për shërbimet online, ashtu edhe i printuar në sportelet e institucioneve. Marrja e një sërë dokumenteve, së shpejti do të kryhet edhe online nga çdo pikë aksesi në internet, 24/7, pasi vula elektronike implementohet për të gjitha shërbimet elektronike që gjenerojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga sistemet elektronike dokumente administrative si vërtetime apo certifikata.

Kjo vlen edhe për biznesin që kërkon p.sh një vërtetim xhiroje për tri vitet e fundit nga Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve: me anë të shkarkimit online në dokumentit të bashku me vulën elektronike shmanget humbja e kohës si dhe veprime të tjera burokratike që do të sillnin kosto të tjera për biznesin. Ky është vetëm një nga disa shërbimet që do të ofrohen me vulë elektronike edhe për lehtësimin e kësaj kategorie. Portali unik e-Albania që është kthyer në urën e vetme të komunikimit online me qytetarët dhe bizneset dhe mbi 500 shërbimet elektronike që ofrohen në të. Implementimi teknik i vulës elektronike është kryer tashmë në portal dhe të gjithë qytetarët shqiptarë kanë mundësi që pasi të identifikohen me të dhënat e tyre, të konsultojnë certifikatën personale apo familjare, vërtetimin e pensionit etj.

Në zbatim të VKM-se Nr. 495, datë 13.9.2017 "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PËRFITIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE ELEKTRONIKE" dhe Urdherit të Ministrit të Brendshëm Nr. 933, date 27.09.2017 për "MARRJEN E MASAVE PËR ZBATIMIN E RREGULLAVE PËR PËRFITIMIN E ÇERTIFIKATAVE NËPËRMJET SHËRBIMIT PUBLIK ELEKTRONIK" njoftojme të gjithë banorët e Bashkisë Lezhë së nga dita e Henë, date 06.11.2017, stafi i Bashkisë Lezhë është pajisur me aksesin në portalin E-Albania dhe është trajnuar me qëllim përfitimin e dokumentave elektronik që iu shërbejnë qytetarët gjatë marrjes së Shërbimeve pranë Bashkisë Lezhë.

Njoftojmë të gjithë qytetarët se tashmë mund të paraqiten pranë sporteleve të Zyrës me Një Ndalesë në Bashkinë Lezhë dhe Njësive Administrative për marrjen e shërbimeve të cilët kërkojnë dokumenta elektronike.

Duhet të theksojmë se ky shërbim nuk zëvendëson në asnjë mënyrë institucionet e tjera, dhe dokumentat tuaja që Bashkia Lezhë mundet të aksesojë janë vetëm për përdorim të brendshëm brenda institucionit tonë.

Faleminderit !

REPUBLICA E SHQIPËRISË	
QARKU Lezhë, BASHKIA Lezhë	
Zyra e Gjendjes Civile	
CERTIFIKATË	LINDJE
Në bazë të të dhënave të mëposhtme:	
Regjistrit Themeltar: VAROSH	Nr. _____ të vitit _____ vërtetohen
Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri e Mbiemri	
Atëria	
Amëria	
Datëlindja	LEZHE, Lezhë
Vendndërsa (fshat/qyteti, rreth)	MASHKULL
Sexi	
Gjendja Civile	SHQIPTARE
Kombësia	SHQIPTARE
Shetërsia	
Data e	
Vendi i	
Shkaku i	
Mosmerrit para pas marrëses	

# Nëntori sportiv në Lezhë

## Futboll

Gjatë kësaj periudhe në qytetin tonë u zhvillua edhe kampionati i kategorisë së parë të futbollit ku spikati barazimi i Shënkollit ndaj skuadrës së vendit të parë dhe me tradita siç është Tirana ku ndeshja përfundoi 1-1. Goli për Shënkollin u shënuar nga Klauudio Pjetrush. E veçanta në shënimin e golit të tij ishte pasi ai ia dedikoi golin vëllait të tij, ish futbollistit dhe arbitrit të njohur, Rigers Pjetrush. Po kështu ekipi elitari, Besëlidhja, barazoi në fushën e vështirë të Dinamos me rezultatin 1-1, por ky barazim nuk ka shumë vlerë pasi e mban ekipin tonë larg kreut që drejtohet nga ana e Kastriotit të Krujës.

Po të mërkurën, Besëlidhja pati dhe takimin e kupës 1/16 me një nga skuadrat më të forta të kampionatit shqiptar, siç është Skënderbeu. Loja u bë e fortë me sulme dhe kundërsulme nga të dyja palët, por në fund fitorja ju buzëqeshi miqve. Ndeshja e kthimit bëhet mbas një jave, por do jetë mjaft e vështirë për ta perbysur rezultatin në mënyrë që Besëlidhja të kualifikohet.

Në fund javë u pritën që të zhvilloheshin kampionatet e të gjitha moshave U17 dhe U19 ku aderojnë Porto, Besëlidhja dhe Brians, por për arsye të përkeqësimit të motit dhe të reshjeve të shiut ato nuk u zhvilluan.



## Ping Pong

Për herë të parë në shkollat e Lezhës u organizua në ambientet e Shkollës "Beslidhja" në bashkëpunim me Federatën e Ping-pongut dhe DAR Lezhë kampionati i ping-pongut të shkollave 9- vjeçare ku spikatën lojrat e bukura dhe me dëshirë në këtë sport të ri. Në këtë sport u dalluan shumë nxënës nga shkolla të ndryshme ,krahas këtij bashkëpunimi në të ardhmen do mundohemi të bëjmë një aktivitet më të zgjeruar.

## Basketboll

BBasketbolli lezhjanë do të përfaqsohet në kombëtarën e moshave me dy sportistë. Kristian Dedëgjona dhe Gerard Balla janë përzgjedhur për të qënë pjesë e ekipit U14. Në këtë mënyrë Lezha nis një epokë të re edhe në basketboll. Edhe pse ky ekip u krijua 16 muaj më parë, ai po prezanton sportistë mjaft premtues e ku sigurisht bëjnë pjesë edhe Kristian Dedëgjona dhe Gerard Balla. Këta dy të rinj sfiduan rivalitetin me

kryeqytetasit duke u përzgjedhur për të qënë pjesë e kombëtares U14. Trajnerët që bënë seleksionimin e konkurrentëve evidentuan menjëherë dy basketbollistët lezhjanë përshkak të cilësive sportive që prazantuan. Mënyra e triblimit, gjuajtjeve në kosh dhe pasimet e Dedëgjona dhe Ballës ishin tipike në grupin e rinjve pjesmarrës në këtë seleksionim duke detyruar trajnerët që të mos kishin asnjë dyshim në përzgjedhjen e tyre. Pavarsisht vështërsive me të cilat sporti lezhjanë përballët, Besëlidhja në basketboll ka nisur të vendosë emrin e saj në mes më të mirëve. Mungesa e terreneve dhe mbështetjes financiare mbetet vështërsia me e madhe, por interesi i të rinjve lezhjanë për t'u marrë me basketboll sa vjen dhe rritet. Në lidhje me këtë ngjarje sportive në Lezhë, trajneri i ekipit të basketbollit Besëlidhja Kliton Pasha thotë se sfida më e madhe e tij mbetet krijimi i ekipeve zingjir, ndërsa siguron se lezhjanët do të përfaqsohen edhe në kombëtarën U16 për djem dhe vajza me të paktën 5 sportistë që në vitin e ardhshëm, e kjo jep garanci për vazhdimsinë e këtij sporti.





Bashkia Lezhë,  
Lagja Shënderbeu,  
Sheshi "Gjergj Kastrioti",  
4501, Lezhë,  
info@lezha.gov.al  
www.lezha.gov.al